



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 89, datë 29.06.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË  
SUBJEKTIT FINANCIAR “EASY PAY” SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e z. Ahmet Çeta, zj. Luljeta Rexhepi, z. Labinot Lleshi, z. Mark Lleshi, z. Albert Rama, zj. Lindita Stafa, z. Serxhjo Zylali, z. Rudolf Hyka dhe zj. Xhuljana Ruçaj, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari subjektit financiar “EASY PAY” sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**